



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.16/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me zyrtaren e lartë ligjore, Antigona Murati duke vendosur përkitazi me ankesën e Aleksandër Jabllanoviq, nga subjekti politik Partija Kosovskih Srba (PKS), paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos pranimit të kandidatëve nga ky subjekt politik për anëtar të këshillave të vendvotimeve(KVV), për Zgjedhjet e Parakohshme të Kuvendit të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 29.05.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HEDHET** si e palejueshme ankesa Anr16-2017 e datës 27.05.2017 e parashtruar nga Aleksandar Jabllanoviq, nga subjekti politik Partija Kosovskih Srba (PKS),

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 27.05.2017, nga Aleksandar Jabllanoviq, Kryetar i subjektit politik PKS, i cili pretendon se Komisionet Komunale Zgjedhore(KKZ) në Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Zubin Potok refuzoi të pranoj listat me kandidat për anëtar të këshillave të vendvotimeve (KVV) si dhe për anëtar të KVV nga koalicioni Partija Kosovskih Srba-Aktivna Gragjanska Inicijativa (PKS-AGI). Parashtruesi i ankesës pretendon se KKZ-të e lartpërmendura haptazi favorizojnë subjektin politik Gragjanska Inicijativa Srpska Lista për të cilën pretendohet se është parti parlamentare, gjë që nuk është e vërtetë sepse kjo iniciativë është regjistruar me datën 15.05.2017 pas shpërbërjes së kuvendit dhe këto KKZ japin përparësi partisë së përmendur të drejtë që ti emërojë kryesuesit të KVV-ve, për dallim nga koalicioni i tyre, të cilët i mohohet e drejta e njejtë. Po ashtu sipas parashtruesi të ankesës ekziston edhe informimi gojor nga ana e kryetareve të KKZ-ve për Mitrovicën e Veriut dhe Zveqan se ata nuk do të pranojnë listën e anëtarëve të për KVV nëse e njëjta nuk është e nënshkruar dhe e vërtetuar nga të dyja partitë që e përbëjnë këtë koalicion gjë që nuk është e mundur në rrethanat reale pasi që

partia e koalicionit AGI është tërhequr nga ky koalicion. Andaj parashtuesi i ankesës kërkon që KQZ-ja ta kordinoj më mirë punën e KKZ-ve në veri të vendit dhe t'ju jep udhëzimet e qarta lidhur me këtë çështje.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 28.05.2017, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit deri më datën 29.05.2017.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ brenda afatit të caktuar me të cilën theksohet se pas shqyrtimit të ankesës të subjektit politik "Partija Kosovskih Srba" (PKS), konsiderojnë se ankesa është e pabazuar për arsye se KQZ-ja më datën 17.05.2017 numri i protokollit 555/2017, ka marrë vendim për miratimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, prandaj ankesa e subjektit politik sa i përket pretendimeve ankimore për listën e kandidatëve për anëtar të KKZ-ve është jashtë afatit ligjor. Sa i përket pretendimeve ankimore për refuzimin e listës së anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), KQZ ende nuk ka marrë vendim për miratimin e KVV, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017.

PZAP-i, pasi e shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

#### **Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se ankesa është e palejuar sepse KQZ-ja në kohën e caktuar i fton të gjitha subjektet politike të certifikuara, të përfaqësuara në Kuvendin Komunal, të cilat garojnë në zgjedhjet e përgjithshme që ti dorëzojnë propozimet e tyre në KKZ për personat që dëshirojnë t'i emërojnë anëtarë të KVV-ve të formuara në kuadër të komunave të tyre duke zbatuar rregullat zgjedhore. KQZ deri me tani ende nuk ka marrë vendim lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2017.

Andaj, mbi këtë bazë paneli vlerëson se pretendimet ankimore të parashtuesit të ankesës se KKZ-të në Zveqan, Zubin Potok, Mitrovicën e Veriut dhe Zubin Potok kanë refuzuar ti pranojnë për anëtar të KVV si dhe për anëtar të KKZ-ve nga koalicioni PKS-AGI, nuk qëndrojnë për faktin se KQZ-ja, ende nuk ka marrë vendim lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2017. Andaj me këtë rast paneli konstaton se ankesa në këtë fazë është e palejuar për tu parashtuar.

Nga arsyet e theksuara më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 16/2017 më datën 29.05.2017

**Kryesuesi i Panelit**

**Fejzullah Rexhepi**



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës*, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.